



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në Ftesën e datës 17.06.2022 e Komisionit të Venecias, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.07.2022, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Udhëtimit Zyrtar në Strasburg të Francës.

- I. Miratohet udhëtimi zyrtar për pjesëmarrjen e KQZ-së në Konferencën e 19-të Evropiane e Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve me temën: “Inteligjenca artificiale dhe integriteti i zgjedhjeve”, që do të mbahet nga data (14-15) nëntor 2022, në Strasburg të Francës.
- II. Pjesëmarrës të udhëtimit zyrtar janë :
 1. Kreshnik Radoniqi
 2. Sami Kurteshi
 3. Ilir Gashi
 4. Fazli Stollaj
 5. Burim Ahmetaj
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.07.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
Prishtinë / Priština



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në vendimin e KQZ-së, të datës 21.07.2022, Nr.907/2022, për Miratimin e Udhëtimit Zyrtar në Strasburg të Francës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur më datën 04.10.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Nr.907/2022, i datës 21.07.2022, për Miratimin e Udhëtimit Zyrtar në Strasburg të Francës

- I. Ndryshohet dhe plotësohet pika II e vendimit Nr.907/2022, i datës 21.07.2022, për miratimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg të Francës.
- II. Në pikën II të vendimit, plotësohet vendimi me pjesëmarrësen në udhëtim zyrtarë znj.Gordana Laban Zuvic.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, të ndërmarrë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.10.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniq






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në ftesën e datës 17.06.2022, të Sekretariatit të Shoqatës së Trupave Botërore të Zgjedhjeve (A-WEB), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.07.2022, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin për aplikim të KQZ-së për zëvendës Kryesues të Shoqatës së Trupave Botërore të Zgjedhjeve (A-WEB) dhe pjesëmarrjen në Konferencë.

- I. Miratohet propozimi për aplikim të KQZ-së për zëvendës Kryesues të Shoqatës së Trupave Botërore të Zgjedhjeve (A-WEB) dhe pjesëmarrjen në Konferencë, e cila do të mbahet nga data (17-22) tetor 2022, në Cape Town, Afrikë e Jugut.
- II. Pjesëmarrës të udhëtimit zyrtar janë :
 1. Kreshnik Radoniqi
 2. Alim Rama
 3. Gordana Laban Zuvic
 4. Burim Ahmetaj
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.07.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Vendimit të KQZ-së Nr.339/2022, të datës 22.02.2022, për Miratimin e Planit të Punës të KQZ-së, për vitin 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.07.2022, nxjerr këtë:



V E N D I M

- I. Miratohet Raporti i realizimit të Planit të Punës të KQZ-së për periudhën janar-qershor 2022.
- II. Raporti si në pikën I, është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 21.07.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Vendimit të KQZ-së Nr.339/2022, të datës 22.02.2022, për Miratimin e Planit të Punës të KQZ-së, për vitin 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.07.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rishikimit të Planit së KQZ-së për vitin 2022

- I. Miratohet rishikimi i Planit të Punës i KQZ-së, për vitin 2022.
- II. Plani i punës i rishikuar si në pikën I, është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 21.07.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KQZ-së
PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2022

Korrik, 2022

1. Hyrje

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pajtim me obligimet që dalin nga Plani vjetor i punës, ka hartuar raportin mbi aktivitetet e zhvilluara për periudha gjashtëmujor. Raporti pasqyron një përmbledhje të përgjithshme mbi aktivitetet dhe angazhimet e Sekretariatit në përmbushje e Planit të Punës.

Raporti, në mënyrë të detajuar e paraqet punën e kryer për secilin aktivitet të paraparë të realizohet në këtë periudhë.

Sipas Plani, për këtë periudhë (janar – qershor 2022) nga 57 aktivitetet që gjithsej ka plani, është paraparë që të fillojnë 52 aktivitete.

- *Shtylla strategjike/ Operacionet Zgjedhore: njëzet e shtatë (27) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Edukimi dhe Informimi i Votuesve: tri (3) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Fuqizimi Institucional: shtatë (7) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Lista e Votuesve: katër (4) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Pjesëmarrja në zgjedhje: një (1) aktivitet.*
- *Shtylla strategjike/ Inovacioni dhe Teknologjia: tri (3) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Bashkëpunimi me Akterët e Jashtëm: tetë (8) aktivitete.*
- *Shtylla strategjike/ Korniza Ligjore: katër (4) aktivitete.*

Auditorit nga raportet vjetore financiare të viteve të kaluara, me qëllim që lëshimet e njëjta mos përsëriten në të ardhmen. Aktiviteti i realizuar 22.02.2022.

Aktiviteti 3:	Hartimi i Dosjes së Informimit Publik
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Mergita Kryeziu
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt – Mars 2022
<i>Tjera:</i>	/

Sipas nenit 43 të LPZ-së Zyra për RPPC krijon dhe ruan Dosjen e Informimit Publik, ku përfshihen regjistri i donatoreve, vlera e kontributit, data në të cilën është dhënë kontributi, raportet financiar të fushatës.

Zyra ka përgatitur Dosjen e Informimit Publik, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, si dhe ka përgatitur Rekomandim për KQZ-në, për publikimin e Dosjes së Informimit Publik.

Dosja e Informimit Publik do të përmbajë: a) Regjistrin e Donatorëve; b) kopjet e të gjitha Raporteve të Publikimit Financiar të Fushatës, të dorëzuara tek Zyra; c) kopjet e të gjithë Formularëve të Publikimit Financiar për kandidatët e certifikuar që janë dorëzuar në Zyrë; dhe d) kopjet e raporteve përfundimtare të kandidatëve të certifikuar lidhur me auditimin e bërë.

KQZ-ja me dt. 22.02.2022, ka marrë Vendim për Publikimin e Dosjes së Informimit Publik të Zgjedhjeve Lokale të datës 17 tetor 2021.

Aktiviteti 4:	Analiza gjinore sipas moshës dhe lidërshipt të partive politike 2017-2021
<i>Statusi:</i>	Duke u realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Valmira Selamni –Vesa Xharra
<i>Periudha e realizimit:</i>	Maj – Gusht 2022
<i>Tjera:</i>	/

Në bazë të të dhënave të cilat janë dorëzuar në Zyrë nga partitë politike, Zyra do të hartoj një raport analitik krahasues për përbërjen gjinore dhe moshës në organet më të larta ekzekutive të partive politike bazuar në të dhënat nga viti 2017 e deri me 2021. Kjo analizë do të përmbajë statistika të moshës dhe gjinisë së anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv të partive politike të regjistruara dhe do të paraqesë një pasqyrë të respektimit të Ligjit për Barazi Gjinore në këto organe vendimmarrëse të partive politike Pas finalizimit dokumenti do të shqyrtohet dhe aprovohet në KQZ si dhe do vendoset nëse do të publikohet.

Ky aktivitet deri me tani është në realizimi e sipër 60% për arsye se, i tërë materiali i dorëzuar zyrës është në kopje fizike, dhe se stafi i zyrës është duke punuar rregullisht në mënyrë manuale me të dhëna individuale.

Tjera:	/
--------	---

Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve ka lëshuar Instruksionin për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2023-2025 në të cilën janë dhënë kriteret e përgjithshme për përgatitjen e këtij dokumenti. Udhëheqësve të departamenteve dhe të divizioneve u është drejtuar me shkresë për hartimin e kërkesave buxhetore dhe përfshirjes së tyre në KASH.

Pasi janë pranuar kërkesat buxhetore nga të gjitha njësitë, janë përpunuar të gjitha të dhënat dhe kërkesat është hartuar dokumenti i KASH-it 2023-2025, i cili është shqyrtuar dhe aprovuar nga menaxhmenti.

Në takimin e KBF të mbajtur më 17.03.2022 është shqyrtuar dhe miratuar KASH 2023-2025 dhe i është propozuar KQZ-së për shqyrtim. KQZ-ja në takimin e mbajtur më 17.03.2022 ka shqyrtuar dhe miratuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve për vitet 2023-2025 dhe brenda afatit e ka proceduar në MFPT.

Aktiviteti : 8	Hartimi i planit të buxhetit 2023 – 2025
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Miradije Meha
Periudha e realizimit:	Maj – Tetor 2022
Tjera:	/

Pas aprovimit të KASH 2023-2025, njësitë kërkuese, divizionet, departamentet, Zyra dhe njësitë tjera janë informuar për procesin e ciklit buxhetor 2023-2025. Po ashtu të gjithë akterët e hartimit të buxhetit janë informuar me Qarkoren buxhetore 2023/01. Kërkesat buxhetore të dërguara nga njësitë kërkuese janë shqyrtuar dhe diskutuar në katër takime të menaxhmentit. Drafti i hartuar nga këto takime është diskutuar dhe aprovuar në mbledhjen e nëntë të Këshillit për Buxhet dhe Financa të mbajtur më 20 qershor 2021. Dokumenti i plotësuar nga Këshilli i është dërguar KQZ-së i cili është aprovuar në mbledhjen e numër 18 të KQZ-së të mbajtur më 21.06.2022 dhe sipas procedurave i është dërguar Departamentit të Buxhetit të MFPT më 23.06.2022.

Faza e parë e këtij aktiviteti është realizuar. Mirëpo pasi planifikimi i buxhetit është cikël, ky aktivitet do të zhvillohet në pajtim me udhëzimet që jepen nga Qeveria e Kosovës në qarkoret e radhës deri në aprovim të Ligjit të Buxhetit për vitin 2023.

Aktiviteti 9:	Raportimi i obligimeve të pa-paguara
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Miradije Meha
Periudha e realizimit:	Janar – Dhjetor 2022
Tjera:	/

Raportimi i obligimeve të pa paguara është planifikuar të raportohet për çdo muaj në MFPT, përkatësisht në Departamentin e Thesarit. Në bazë të Rregullës financiare 02/2013 të MF organizatat buxhetore janë të obliguara që deri më datën 15 të raportojnë çdo muaj faturat e pa paguara për muajin paraprak.

<i>Tjera:</i>	/
---------------	---

Në Planin e Punës Raporti vjetor Financiar i KQZ-së për vitin 2021 është i planifikuar të realizohet në fund të janarit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatit, shqyrton dhe aprovon Raportin vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. Raporti është përgatitur, shqyrtuar dhe miratuar nga KQZ-ja dhe është dërguar në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve.

Aktiviteti 13:	Raporti i shpenzimeve për Zgjedhjet Lokale 2021
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Miradije Meha
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt 2022
<i>Tjera:</i>	/

Në Planin e punës Raporti i shpenzimeve të zgjedhjeve lokale 2021 është i bazuar në nenin 113.6 të Ligjit për Zgjedhjet, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve prej ditës së shpalljes së rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, KQZ-ja do të publikoj një raport të plotë për shpenzimet zgjedhore dhe mënyrën e shpenzimit për Zgjedhjet e lokale 2021.

Raporti është përgatitur dhe shqyrtuar në KBF të mbajtur me 28.02.2022 në të cilin janë shpalosur informatat duke filluar që nga planifikimi i buxhetit e deri te shpenzimet e realizuara në procesin zgjedhor. Ky raport është aprovuar nga KQZ-ja me 09.03.2022.

Aktiviteti 14:	Raporti vjetor financiar (2021) për Kuvendin e Kosovës
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Miradije Meha
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt – Prill 2022
<i>Tjera:</i>	/

Në Planin e Punës Raporti vjetor Financiar i KQZ-së për vitin 2021 është i planifikuar të realizohet në fund të janarit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatit, shqyrton dhe aprovon Raportin vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. Raporti është përgatitur, shqyrtuar dhe miratuar nga KQZ-ja dhe është dërguar në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve.

Aktiviteti 15:	Raporti vjetor financiar për fondin e subjekteve politike 2021 për Kuvendin e Kosovës
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Miradije Meha
<i>Periudha e realizimit:</i>	Qershor 2022
<i>Tjera:</i>	/

Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Nexhmi Haxhiu
Periudha e realizimit:	Mars, Qershor, Shtator, Dhjetor 2022
Tjera:	Raportet çdo tre muaj

Në gjashtëmuajorin e parë (deri më 30.06.2022), sipas plani të prokurim kanë qenë të planifikuar të zhvillohen:

I. Kontrata për furnizim-10 kontrata, prej tyre;

5 janë realizuar .

2 janë anuluar

1 në procedurë

2 nuk janë zhvilluar procedurat (priten specifikat)

II. Kontrata për shërbime, 7+1 kontratë të pa planifikuar 8 gjithsejtë, prej tyre;

4 janë realizuar

2 janë anuluar

2 nuk janë zhvilluar procedurat (priten specifikat)

Një aktivitet i prokurimit (i anuluar)-Sigurimi fizik i objekteve të KQZ-së me numër të prokurimit të brendshëm 320-22-002-2-2-1, pas anulimit të këtij aktiviteti ka pasur ankesë në OSHP nga Operatori Ekonomik dhe ky aktivitet është pezulluar deri në një vendim të OSHP-së.

Deri me 30.06.2022 janë procesuar 23 urdhërblerja dhe nuk kemi obligime të pakryera ndaj Operatoreve Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ka në shfrytëzim 10 kontrata të AQP-së

7 Kontrata- Furnizim me material administrativ i ndarë në Lloto I,II,III,IV ,V,VI,VII,

1 Kontratë - Furnizim me ujë pije të pa-gazuara .

1 Kontratë- Shfrytëzimi fotokopje dhe printerëve me qira Lloto I

1 Kontratë -Furnizim me karburante Lloto III.

Me gjerësisht shih tabelën

Statusi i aktiviteteve të prokurimit deri me 30.06.2022

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM			
Përshkrimi i Kontratës	Nr.	Statusi i aktivitetit	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
Furnizim me pako promovuese	1	priten specifikat	01.06.2022
Furnizim me inventarë/DAP-I	2	i anuluar	28.03.2022
Kufje te aparateve te dëgjimit	3	i përfunduar	01.03.2022
Furnizim me SSL Certifikata	4	i përfunduar	25.01.2022
Furnizim me llap top	5	i përfunduar	07.02.2022
Furnizim me projektor	6	i përfunduar	01.03.2022
Furnizim me kablo siguroese për llap top (kensingstonlock)	7	i përfunduar	03.02.2022
Furnizim me sistemin e kamerave	8	i anuluar	07.03.2022

Me rekomandim nga Këshilli për Operacione Zgjedhore në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2022 Komisioni Qendror të Zgjedhjeve miratoi: Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve nga Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian nga Zgjedhjet Lokale të vitit 2021. Zbatimi i Planit të Veprimit për adresim të rekomandimeve nga raportet të vëzhguesve të Zgjedhjeve Lokale 2021 është në realizim.

Aktiviteti 23:	Analizë e fletëvotimeve të pavlefshme për Zgjedhjet Lokale 2021
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Komisionin i emëruar nga KE i SKQZ-së
Periudha e realizimit:	Shkurt – Qershor 2022
Tjera:	/

Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së, ka nxjerre vendimin nr.370/2022, të datës 28.02.2022, për formimin e komisionit për analizimin e fletë votimeve të pavlefshme të zgjedhjeve lokale, të 17 tetorit 2021. Komisioni gjatë kësaj periudhe ka përgatitur raportin dhe ka bërë analizimin e fletëvotimeve të pavlefshme të zgjedhjeve lokale 2021 dhe krahasimin e tyre me fletëvotimin e zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe 2017. Raporti nga komisioni është prezantuar për shqyrtim në mbledhjen nr.15/2022 të Këshillit të Operacioneve Zgjedhore me datën 23.06.2022. KOZ-ja ka rekomanduar raportin për shqyrtim dhe miratim në KQZ. Ky dokument është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur me numër nr.19/2022, te dates 06.07.2022.

Aktiviteti 24:	Raporti për vendvotimet e rinumëruara për Zgjedhjet 2009 – 2021
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Komisioni i emëruar nga KE i SKQZ-së
Periudha e realizimit:	Mars – Korrik 2022
Tjera:	/

Gjatë kësaj periudhe është bërë analizimi numerik i rinumërimit të vendvotimeve të zgjedhjeve lokale të vitit 2021, ku janë pasqyruar dallimet në vota të subjekteve dhe kandidatëve nga vendvotimet e rinumërimeve. Gjatë muajve në vijim do të bëhet edhe analizimi i pjesës nga vitet paraprake. Ky aktivitet është planifikuar të përfundoj në fund të muajit korrik 2022.

Aktiviteti 25:	Publikimi i dytë i trendeve zgjedhore në Republikën e Kosovës
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Valmir Elezi
Periudha e realizimit:	Shkurt – Qershor 2022
Tjera:	/

Ka filluar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për përgatitjen e publikimit të dytë të trendeve zgjedhore, ku do të përfshihen edhe të dhënat për dy proceset zgjedhore të vitit 2021. Dokument është në përfundim e sipër dhe së shpejti do të jetë i gatshëm për tu prezantuar.

Për këtë dy aktivitete janë hartuar raporte informuese të cilët janë përcjellë për informim në Këshillin e Operacioneve Zgjedhore dhe KQZ.

Aktiviteti 29:	Shqyrtimi, miratimi dhe zbatimi i projektit "informimi publik dhe edukimi i votuesve të rinjë për zgjedhje"	
Statusi:	Duke u realizuar	
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Azemine Beqiri	
Periudha e realizimit:	Maj-Dhjetor – 2022	

Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve sipas planit të punës së KQZ-së 2022, ka përgatitur projektin "Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje".

Ky projekt ka për qëllim informimin, edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjve të cilët kanë mbushur ose i mbushin 18 vjet, deri në zgjedhjet e ardhshme, për rolin që mund të luajnë në përmirësimin e jetës, duke marrë pjesë aktive në procesin zgjedhor.

Përbushja e objektivave të këtij projekti do të arrihet përmes organizimit të ligjëratave, diskutimeve, simulimit të votimit, shpërndarjes së materialeve informuese të cilat do të organizohen duke u shtrirë në të gjitha shkollat e mesme në tërë vendin, nga të cilat mund të përfitojnë direkt rreth 24,000 maturantë.

Projekti ju është dërguar organizatave të shoqërisë civile, si: "Demokracia në Veprim", "Demokrati Plus", "D4D", "KDI", "ÇOHU", "Aktiv", "Qendra Kosovare për Studime Gjinore", "Handikos" dhe "RADC", që të japin komente apo sugjerime. Nga këto OSHC, nuk është pranuar ndonjë koment lidhur me këtë projekt.

Projekti është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ-it nr. 13/2022, ku është kërkuar të bëhen disa plotësime të cilat u plotësuan, dhe në mbledhjen nr. 15/2022, me datë 23.06.2022 u miratua.

Ky dokument është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur me numër nr.19/2022, te datës 06.07.2022.

Aktiviteti 30:	Hartimi i strategjisë për edukimin dhe Informimin e votuesve në vitet jo zgjedhore	
Statusi:	Duke u realizuar	
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Azemine Beqiri	
Periudha e realizimit:	Maj-Dhjetor 2022	

Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve ka filluar hartimin e Strategjisë për Edukim dhe Informim të Votuesve në vitet jo zgjedhore.

Qëllimi i Strategjisë është informimin dhe edukimin e votuesve për zgjedhjet në vitet jo zgjedhore duke u bazuar në analizat dhe raportet e vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar, analizën e votave me asistencë, analizën e votave të pavlefshme dhe analizën e votave me kusht.

Ky aktivitet është në proces e sipër. Fillimisht Komisioni për Inventarizim ka bërë regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë jo financiare të KQZ-së dhe ka përgatitur raportin. Pastaj Komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare ka vlerësuar pasurinë jo financiare dhe ka përgatitur raportin e vlerësimit. Në muajin prill do të vazhdoj procesi për implementimin e këtij aktiviteti. Janë formuar nga Kryeshefi Ekzekutiv komisionet për vlerësim të dënimit dhe të shitjes nëpërmjet ankandit. Ky aktivitet është planifikuar të përfundoj në fund të muajit dhjetor 2022.

Aktiviteti 35:	Raporti punës së KQZ-së në vitin 2021 për Kuvendin e Kosovës
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Valmir Elezi
Periudha e realizimit:	Mars – Prill 2022
Tjera:	/

Raporti vjetor i punës së KQZ-së për vitin 2021 është miratuar në Këshillin për Operacione Zgjedhore dhe i njëjti është miratuar nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë raport, si aneks janë bashkëngjitur edhe raporti vjetor financiar i KQZ-së për vitin 2021. Raporti është dërguar në Kuvend të Kosovës më datën 29.04.2022.

Aktiviteti 36:	Vizita studimore për përdorimin elektronik të identifikimit të votuesve
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Këshilli për Marrëdhënie me jashtë
Periudha e realizimit:	Maj-Qershor
Tjera:	/

Në përputhje me Planin e Punës të KQZ-se për vitin 2022, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, nga data 14-17 qershor 2022, është realizuar vizita në Komisionin Shtetëror të Malit të Zime qëllim të shkëmbimit të përvojave në përdorimin e teknologjisë në zgjedhje, ku është prezantuar aplikimi i Sistemit Elektronik të Identifikimit të Votuesve (EVID) në Mal të Zi. Po ashtu, me kërkesën e KSHZ-së së Malit të Zi, KQZ-ja e Kosovës ka prezantuar Sistemin e transmetimit të rezultateve preliminare në natën e zgjedhjeve.

Pjesë e delegacionit ishin: Kryetari i KQZ-së Kreshnik Radoniqi, Anëtarët: Sami Hamiti, Ilir Gashi, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Bujar Basha-Këshilltar Kombëtar i Zgjedhjeve/ Udhëheqës i Ekipit të Zgjedhjeve nga OSBE dhe Kreshnik Spahiu-Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informativë në KQZ. Për këtë aktivitet është hartuar raporti informues i cili është përcjellë për informim në KOZ dhe KQZ.

Kjo ngjarje ka ndihmuar KQZ-në dhe Sekretariatit për kuptimin e përgatitjeve dhe sfidave për aplikimin e këtij sistemi, me qëllim të analizojë mundësitë dhe opsionet e përdorimit të teknologjive në zgjedhje në të ardhmen në Kosovës,

Aktiviteti 37:	Hartimi i Planit Strategjik të KQZ-së 2023-2026
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi mix: KQZ/SKQZ
Periudha e realizimit:	Maj-Dhjetor
Tjera:	/

Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka përgatitur kërkesën me qëllim të pajisjes me të dhënat e shtetasve nga ARC – Departamenti i Gjendjes Civile. Kërkesa e protokolluar është dërguar me datën 04.04.2022. Ndërsa, nga të dhënat në formatin elektronik (CD) të dhënat e kërkuara janë pranuar me datën 06.05.2022.

Aktualisht, në kuadër të veprimeve që janë marrë për këtë aktivitet, janë analizuar të dhënat e përgjithshme për tipin e të dhënave dhe evidentimi i dallimeve për katër komuna, si mostër. Dallimet e evidentuara kanë të bëjnë me dy baza: Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve, nga ku edhe krijohet lista e votuesve dhe Departamenti i Gjendjes Civile.

Gjithashtu, në kuadër të kësaj analize, me datën 24.05.2022, nga Agjencia Kadastrale e Kosovës kemi pranuar të dhënat e emrave të rrugëve të miratuara nga 33 komuna të Republikës së Kosovës, për të cilat jemi duke bërë ndërlidhjen dhe analizimin.

Raporti i lartpërmendur është përfunduar dhe dërguar përmes e-mailit, me datën 30.05.2022. Ndërsa, Këshilli i Operacioneve Zgjedhore ka shqyrtuar dhe miratuar këtë analizë, në mbledhjen numër 15/ 2022, e mbajtur me datën 23.06.2022.

Ky dokument është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur me numër nr.19/2022, te datës 06.07.2022.

Aktiviteti 40:	Analizimi e votave me kusht nga zgjedhjet lokale të 2021	
Statusi:	Duke u realizuar	
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Besnik Buzhala -Premtim Rrustemi	
Periudha e realizimit:	Qershor-Korrik 2022	

Aktiviteti është i planifikuar të realizohet në periudhën: tre mujori i dytë dhe i tretë: qershor – korrik 2022.

Divizioni i Shërbimit të Votuesve pas analizimit të votave me kusht, ka hartuar draft raportin, i cili është dërguar për shqyrtim tek Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ – së dhe Drejtori i Departamentit për Operacione Zgjedhore, me datë 11.05.2022.

Aktiviteti 41:	Puna e Grupit Punues për përmirësimin e Listës Votuese	
Statusi:	Duke u realizuar	
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Besnik Buzhala	
Periudha e realizimit:	Shtator – Dhjetor 2022	
Tjera:	/	

Aktiviteti është i planifikuar të realizohet në periudhën: tre mujori i tretë dhe i katërt: shtator – dhjetor 2022.

Ndërsa, me datën 29.03.2022, në kuadër të bashkëpunimit me ARC-në, është realizuar një takim me përfaqësuesit e Departamentit të Gjendjes Civile, që ka pas për qëllim marrjen e

2.6. INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA

Aktiviteti 43:	Modifikimi dhe avancimi i ueb faqes së KQZ-së
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Kreshnik Spahiu dhe Visar Kastrati
Periudha e realizimit:	Mars – Nëntor 2022
Tjera:	/

DTI ka bërë analizimin e strukturës dhe dizajnit të ueb faqes dhe ka përpiluar termat e referencës dhe specifikimet teknike për modifikimin dhe avancimin e ueb faqes së KQZ-së. Në të njëjtën kohë janë rishikuar edhe kërkesat që dalin nga Udhëzuesi për Ueb faqet e Institucioneve Publike i AIP-së. Projekti sipas Planit të Punës është shqyrtuar dhe aprovuar në KOZ me datë 29.03.2022 dhe është aprovuar në mbledhjen numër 12/2022. Pas aprovimit DTI ka proceduar me kërkesën e aprovuar për iniciimin e aktivitetit të prokurimit. Meqë nuk kishte ofertues të përgjegjshëm aktivitetit është anuluar dhe me datë 06.06.2022 përsëri është iniciuar kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit

Me datë 30.03.2022 është nënshkruar kontrata dhe në të njëjtën kohë është përgatitur plani për menaxhimin e kontratës për këtë aktivitet. Në muajt në vazhdim do të bëhet implementimi i kërkesave dhe ndryshimet e nevojshme në ueb.

Aktiviteti 44:	Ripërtëritja e pajisjeve të TI
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Kreshnik Spahiu, Hava Morina dhe Premtim Rrustemi
Periudha e realizimit:	Prill – Nëntor 2022
Tjera:	/

Në këtë aktivitet përfshihet ripërtëritja e pajisjeve të TI-së përmes tri aktiviteteve të prokurimit. Sipas Planit për dy aktivitete me datë 10.02.2022 janë dërguar kërkesat në prokurim për furnizim me laptop dhe furnizim me projektorë. Aktiviteti për furnizim me projektorë për ZLKZ-të është realizuar dhe janë pranuar projektorët për shpërndarje tek ZLKZ-të.

Për këto pajisje është përgatitë edhe një manual i përdorimit dhe do të trajnohen për përdorim zyrtarët përkatës. Në lidhje me aktivitetin tjetër për furnizim me laptop është proceduar kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit me datë 10.02.2022. Pasi që nuk kishte ofertues të përgjegjshëm aktivitetit është anuluar dhe me datë 24.03.2022 përsëri është iniciuar kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit. Kontrata është nënshkruar me datë 30.06.2022 dhe deri në muajin gusht pritet liferimi i pajisjeve të kontraktuara. Në fund, në fillim të muajit korrik do të procedohet edhe kërkesa për zhvillimin e procedurave për furnizim me pajisje për serverë dhe pajisje përcjellëse.

ZRPPC është në finalizim e sipër të rekomandimeve për shqiptimin e gjobave sipas raportit të auditimit, dhe se brenda afatit të paraparë me plan të punës do t'i procedoj në KQZ rekomandimet në fjalë.

Aktiviteti 49:	Raportimi për procesin e dorëzimit të azhurnimeve vjetore të të dhënave të partive politike të regjistruara
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Valmira Selmani
Periudha e realizimit:	Janar – Shkurt 2022
Tjera:	/

Në bazë të nenit 11, të Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Zyra për RPPC më datën 11 janar 2022, i ka njoftuar partitë politike për afatin ligjor të sjelljes së Azhurnimeve Vjetore, data e fundit për dorëzimin e azhurnimeve ishte deri më 31.01.2022. Dyzetë e tetë (48) parti politike i kanë dorëzuar azhurnimet brenda afatit ligjor ndërsa një (1) parti politike "Lëvizja Forca e Diasporës" pas afatit, me vonesë prej 10 ditëve. Me datën 22.02.2022, pas rekomandimit të Zyrës, KQZ-ja ka marrë Vendim për shqiptimin e gjobës, në shumë prej (320 €) për partin politike "Lëvizja Forca e Diasporës". Aktiviteti i realizuar 22.2.2022.

Aktiviteti 50:	Raportimi për dorëzimin e raporteve të shpenzimeve vjetore të partive politike të regjistruara
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Mergita Kryeziu
Periudha e realizimit:	Mars 2022
Tjera:	/

Në bazë të ligjit për zgjedhje, PP-të dorëzojnë raportet e shpenzimeve vjetore të partive politike deri më 1 mars 2022. ZRPPC do të hartoj një raport ku ceket nëse raportet janë dorëzuar në kohë nga të gjitha partitë politike. Në raste kur partitë politike dështojnë të dorëzojnë këto raporte, ZRPPC përgatit edhe rekomandimin për masa administrative apo shqiptim të gjobave si dhe draftin vendimet gjegjëse. Nga dyzetë e nëntë (49) parti politike të regjistruara, të gjitha e kanë dorëzuar Raportin Vjetor Financiar në afat ligjor.

Aktiviteti 51:	Raportimi për dorëzimin e deklarimeve të partive politike për vazhdimin e regjistrimit
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Valmir Selmani
Periudha e realizimit:	Mars 2022
Tjera:	/

Në bazë të nenit 12.6 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në Rregullën Nr. 01/2013, në nenin 7, secila Parti Politike e regjistruar duhet të lajmërojë vazhdimin e regjistrimit të partisë politike, çdo vit jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik duke dorëzuar Formularin për

- Gjithashtu, plani i veprimit ka paraparë edhe një plan të vizitave duke i'u referuar prioriteteve që janë paraqitur, si dhe në kuadër të planit është hartuar shkresa për Kryetar të komunave me të cilën do të kërkohet organizimi i takimit.

Ky aktivitet u shqyrtua në Mbledhjen nr. 14/2022 të Këshillit për Operacione Zgjedhore të datës 20 qershor, dhe u vendos që të shtyhet për muajin Shtator, me arsyetimin se deri atëherë, në kuadër të kërkesave specifike për secilën komunë të plotësohet edhe me kërkesa të tjera drejtuar Kryetarëve, duke mos u fokusuar vetëm në ato të kushteve të punës, por të diskutohet edhe për Qendrat e votimit në zonat urbane, qasjen e personave me nevoja të veçanta në zyrat e ZLKZ-ve dhe në Qendra të votimit, qasje në internet publik, etj. Po ashtu u dha rekomandim që shkresa për Kryetar të jetë vetëm ftesë për takim, dhe të mos përmbaj specifika për diskutime.

Ky aktivitet është planifikuar të përfundoj në fund të muajit dhjetor 2022.

2.8. KORNIZA LIGJORE

Aktiviteti 54:	Rishikimi i legjislacionit sekondar të KQZ-së (Rregullave të Zgjedhjeve)
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi Punues SKQZ/ZRPPC
Periudha e realizimit:	Mars – Prill 2022
Tjera:	/

Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së me datën 23.02.2022, ka nxjerr vendimin nr.343/2022, për formimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullave zgjedhore.

Grupi punues ka hartuar Planin dinamik për ndryshim/ plotësimin e rregullave zgjedhore me qëllim që të identifikohen hapat radhë pas radhe, dhe të cilat do të ndërmerren në kuadër të realizimit të aktiviteteve të planifikuara me Planin e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022.

Në mbledhjen e Këshillit për Çështje Ligjore nr.07/2022 të datës 22.02.2022, Planin dinamik për ndryshim/ plotësimin e rregullave zgjedhore është shqyrtuar kurse me datën 22.02.2022, në mbledhjen nr.07/2022, të KQZ-së është miratuar.

KQZ me qëllim të implementimit të këtij aktiviteti sipas, Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2022, ka organizuar punëtorin pesëditore me temën: "Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullave zgjedhore të punës së KQZ-së", nga data 17 -21 prill 2022. Draftet e shqyrtuar në punëtori janë duke u finalizuar në Këshillin për Operacione Zgjedhore KQZ dhe në momentin që ato të finalizohen, do të prezantohen për miratim në KQZ. Këtë aktivitet KQZ ka propozuar që të finalizohet deri në fund të muajit nëntor 2022.

Aktiviteti 55:	Plotësim/ndryshimi i Rregullave të Brendshme të KQZ-së
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi Punues SKQZ/ZRPPC
Periudha e realizimit:	Prill – Dhjetor 2022

Kryeshefit Ekzekutiv ka nxjerr vendimin nr.620-2022 dhe 620/A—2022, për formimin e Grupin Punues për plotësim ndryshimin e Rregulloreve dhe Udhëzimeve të brendshme të KQZ-së.

6. Udhëzimin Administrativ 06/2022 për shfrytëzimin e Telefonisë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Ky aktivitet sipas Planit të Punës është planifikuar që të realizohet nga muaji Prill deri në muajin dhjetor 2022, ku të gjitha udhëzimet e brendshme, do të shqyrtohen në Këshillat e KQZ-se dhe miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Aktiviteti 57:	Rekomandimet e KQZ-së për plotësim/ndryshim të LZP-së
Statusi:	Duke u realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi Punues SKQZ/ZRPPC
Periudha e realizimit:	Mars – Dhjetor 2022
Tjera:	/

KQZ ka filluar punën për Rishikimi i legjislacionit sekondar të KQZ-së (Rregullave të Zgjedhjeve). Gjatë rishikimit të këtyre rregullave, do të përgatitet një raport me rekomandimet e mundshme të cilat KQZ do t'i dërgoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për Reformën zgjedhore.

Gjithashtu, KQZ ka identifikuar edhe dispozitat e mundshme që mund të përfshihen në Koncept dokumentin për Ligjin Nr.03/L-072 për zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të cilat do të cilat janë prezantuar nga anëtari i KQZ-së në grupin punues të udhëhequr nga MAPL për hartimin Koncept dokumentin për Ligjin Nr.03/L-072 për zgjedhjet Lokale, në punëtorin e përbashkët e grupit punues për Koncept dokumentin për Ligjin Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës 28-30 Qershor 2022 në Prizren. Ky aktivitet do të përkrahet nga Ekipi i zgjedhjeve të OSBE - së.

3. PROGRESI NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS

Në planin e punës së KQZ-së për vitin 2022 janë planifikuar të realizohen 57 aktivitete. Për këtë periudhë gjashtëmujore (janar-qershor) sipas Planit janë paraparë të fillojnë 52 aktivitete. Puna ka filluar dhe është evident progresi në të gjitha këto aktivitete apo 91 % e Planit të Punës.

Sipas informatave për progresin e aktiviteteve, nga 23 aktivitete të parapara të realizohen brenda kësaj periudhe, 19 janë realizuar plotësisht, ndërsa 4 aktivitete janë në realizim e sipër. Po ashtu brenda kësaj periudhe është përfunduar një aktivitet, i cili sipas Planit ka qenë i paraparë të përfundojë në periudhën vijuese të vitit. Pra, gjithsej janë realizuar në tërësi 20 aktivitete apo shprehur në përqindje 35 % e Planit të Punës apo 83.3% e aktiviteteve të parapara për këtë periudhë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Vendimit të KQZ-së Nr.339/2022, të datës 22.02.2022, për Miratimin e Planit të Punës të KQZ-së, për vitin 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.07.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rishikimit të Planit së KQZ-së për vitin 2022

- I. Miratohet rishikimi i Planit të Punës i KQZ-së, për vitin 2022.
- II. Plani i punës i rishikuar si në pikën I, është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 21.07.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në Ftesën e datës 30.06.2022, të Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Letonisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.07.2022, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Udhëtimit Zyrtar në Letoni

- I. Miratohet udhëtimi zyrtar për pjesëmarrjen e KQZ-së në zgjedhjet e 14-të Saeima (zgjedhjet parlamentare) në Letoni që do të mbahen më 1 tetor 2022.
- II. Pjesëmarrës të udhëtimit zyrtar janë :
 1. Ibrahim Selmanaj
 2. Sami Hamiti
 3. Rifat Krasnic
 4. Arianit Elshani
 5. Nexhmedin Hyseni
 6. Kreshnik Spahiu
 7. Valbona Kida
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.07.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniq

